

**AKT THEMELIMI I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“JORN”sh.p.k**

**KREU I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**  
**Neni 1**  
**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot më datë 04/11/2024, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**JORN**”sh.p.k., në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”.

Themeluesit e Shoqërisë janë:

- 1) **MARIGLEN DERVISHLLARI**, atesia URIM i lindur ne Cangonj Korce me 22.06.1996 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i pajisur me dok identifikimi Id me nr **036828402** dhe Nr personal **J60622055L**
- 2) **JORGJI DUSHA** atesia Emiljano i lindur ne Tirane me 23.05.1999 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i pajisur me dok identifikimi pasaporte me nr BE0842203 dhe Nr personal **J90523029E**

**Neni 2**  
**Objekti**

Shoqëria “**JORN**”sh.p.k. do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e import – export dhe tregeti me shumice dhe pakice të artikujve kozmetike. Importimin e produkteve të gatshme, veshmbathje etj, të kësaj natyre, me perberje tekstili, pambuku si dhe pajisje parukerie, si dhe shitjen e tyre me shumice dhe pakice.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria “**JORN**”sh.p.k., do ta zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 4**  
**Selia**

Selia e shoqërisë “**JORN**”sh.p.k., do të jetë në adresën:

**Rruga: DERVISH HIMA 3 KULLAT KULLA 3 KATI 1 TIRANE**

**KREU II**

**Kapitali**

**Neni 5**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2.000.000(dy milion) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:



- 1) Ortaku themelues MARIGLEN DERVISHLLARI Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 1,020,000 (nje milion e njezet mije) lekë që përbën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Ortaku themelues JORGJI DUSHA Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 980,000 (njeteqind e tetedhete mije ) lekë që përbën 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 6**

### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- e) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- f) Shitblerjes;
- g) Trashëgimisë;
- ç) Dhurimit;
- h) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj;

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht tëtransferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave.

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE**

#### **Neni 8**

### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i vetëm i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

14. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
15. Ndryshimin e statutit;
16. Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
17. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të miratuar;
18. Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabël;
19. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
20. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
21. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
22. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
23. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
24. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
25. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të shoqërisë;
26. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuotimi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, në të njëjtin rend dite.

## NENI 11


Dispozita me te hollesishme jane parashtruar ne statutin e kesaj shoqerie e cila shpreh vullnetin e lire te themeluesve.

Ortakeve pasi u lexohet akti i mesiperm e eshte sipas vullnetit te tyre te lire e te plote e firmosin rregullisht para meje noteres e une noterja e vertetoj sipas Ligjit.

### ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ JORN ”sh.p.k

**MARIGLEN DERVISHLLARI**

**JORGJI DUSHA**

Jorgji Dusha  


Mariglen Dervishllari  
